Jo të gjitha gjykatat përdorin sistemin e unifikuar të menaxhimit të rasteve për ndarjen e tyre. Praktikrat jo-transparente, si caktimi i rasteve me short, ekzistojnë ende. Gjykatat nuk mbajnë regjistër të rasteve nga të cilat janë përjashtuar gjykatës apo që kanë kërkuar të përjashtohen. Sistemi i trajtimit të rasteve i shërbimit të prokurorisë, ngritur së fundmi, ende nuk operon plotësisht në vend.	OBJEKTIVI 5: Përmirësimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë duke siguruar sisteme moderne elektronike dhe lehtësira për zhvillimin e bashkëpunimit të fuqishëm ndërkombëtar.
Llogaridhënia	
Nuk ka monitorim të mjaftueshëm të përputhjes me standardet etike dhe integritetin kur emërohen gjyqtarë dhe prokurorë.	OBJEKTIVI 1: Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektivitetit dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë.
Nuk ka këshillim apo trajnim të detyrueshëm gjatë shërbimit për etikën.	OBJEKTIVI 2: Konsolidimi i arsimit ligjor dhe trajnimit si dhe specializimi i magjistratëve dhe personelit të gjykatave.
Kuadrit ligjor për procedime disiplinore i mungon qartësia dhe procedime të tilla mund të përdoren për të influencuar keq gjyqtarët. Ministri i Drejtësisë ka pushtet i vetëm — dhe liri veprimi — për të ngritur procedime disiplinore kundër gjyqtarëve, çka është në kundërshtim me standardet e BE-së.	OBJEKTIVI 1: Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektivitetit dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë
Gjyqtarët dhe prokurorët janë të detyruar të deklarojnë pasuritë e tyre çdo vit. Megjithatë, me gjithë rastet e shumta të raportuara të mospërbushjes së kësaj kërkesë,	OBJEKTIVI 1: Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektivitetit dhe llogaridhënies



deri tani nuk janë marrë vendime përfundimtare për sanksione. Gjyqësori perceptohet përgjithësisht si shumë i korruptuar.	së institucioneve të sistemit të drejtësisë.
Profesionalizmi dhe kompetenca	
<p>Kërkesa e profesionalizmit dhe integritetit nuk reflektohet mjaftueshëm në kriterin ekzistues për gjyqtarët. Janë vendosur kritere për vlerësimin e prokurorëve, por kriteret e qarta dhe transparente për vlerësimin dhe promovimin e gjyqtarëve ende nuk janë miratuar. Vendimet që lidhen me karrierat e gjyqtarëve nuk janë plotësisht transparente dhe jo gjithnjë bazohen mbi merita dhe kritere të tjera objektive.</p> <p>Vitet e fundit, procesi i emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë është prishur nga seanca dëgjimore të diskutueshme në Komisionin Parlamentar të Çështjeve Ligjore dhe refuzimet e shpeshta nga Kuvendi të emërimeve presidenciale.</p> <p>Pavarësia dhe llogaridhënia e sistemit të prokurorisë dobësohet më tej nga fakti se Prokurori i Përgjithshëm emërohet me pëlqimin e një shumice të thjeshtë të Kuvendit. Procedurat për emërimin, promovimin dhe largimin e stafit kyç në zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm u mungon transparenca.</p>	OBJEKTIVI 1: Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektivitetit dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë.
Cilësia e drejtësisë	
<p>Trajnimet gjyqësore fillestare dhe gjatë shërbimit sigurohen nga Shkolla e Magjistratëve dhe financohen pjesërisht nga donatorë të huaj për shkak të mungesave të vazhdueshme në buxhet. Ekziston një program trajnimi mbi precedentin ligjor të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por trajnimi mbi <i>acquis</i> e BE-së është i kufizuar. Shqipëria ende nuk merr pjesë në Rrjetin Evropian të Trajnimit Gjyqësor.</p> <p>Shkolla Kombëtare e Juristëve ende nuk siguron trajnim gjatë shërbimit për juristët.</p>	OBJEKTIVI 2: Konsolidimi i arsimit ligjor dhe trajnimit, si dhe specializimi i magjistratëve dhe personelit të gjykatave
Planifikimi dhe shpërndarja e burimeve administrative dhe financiare brenda gjyqësorit duhet përmirësuar.	OBJEKTIVI 1: Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektivitetit dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë.
Shumë mjedise gjykatash kërkojnë rinovim të mëtejshëm. Disa gjykata nuk kanë mjaftueshëm salla gjyqi dhe seancat dëgjimore ende zhvillohen në zyrat e gjyqtarëve, çka rrit	OBJEKTIVI 5: Përmirësimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë duke siguruar sisteme



riskun për praktika të korrupuara.	moderne elektronike dhe lehtësira për zhvillimin e bashkëpunimit të fuqishëm ndërkombëtar.
Qasja online e legjislacionit në formë të konsoliduar nuk disponohet. Ekziston një bazë të dhënash precedentësh, por publikimi i vendimeve gjyqësore mbetet i parregullt dhe nuk ka mjete efektive kërkimore. Gjykata e Lartë ka nxjerrë vetëm pak rregulla që unifikojnë precedentët ligjorë. Sistemi për njoftimin e palëve dhe dëshmitarëve është i papërshtatshëm.	OBJEKTIVI 5: Përmirësimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë duke siguruar sisteme moderne elektronike dhe lehtësira për zhvillimin e bashkëpunimit të fuqishëm ndërkombëtar,
Ligji mbi Ndërmjetësimin siguron një mekanizëm alternativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, por adresimi të ndërmjetësimi është i rrallë.	OBJEKTIVI 8: Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve ligjore dhe vendosja e një kuadri ligjor për arbitrazhin.
Efikasiteti	
<p>Kohëzgjatja e përgjithshme e procedimeve nga fillimi deri te vendimi përfundimtar mbetet një shqetësim i madh.</p> <p>Nuk ka mekanizëm efektiv monitorimi dhe ka një mungesë të përgjithshme kapaciteti për të prodhuar të dhëna të qëndrueshme statistikore.</p> <p>Dispozitat e paqarta të Kodit Civil dhe Kodit të Procedurës Penale reduktojnë gjithashtu efikasitetin e gjykatave.</p> <p>Përqindja e rasteve të zgjidhura, pra raporti i rasteve të zgjidhura me rastet e reja të regjistruara është rritur vitet e fundit me disa diferenca sipas llojit të gjykatës. Rastet e mbledhura mbeten të shumta, veçanërisht në gjykatat administrative dhe në Gjykatën e Lartë.</p>	OBJEKTIVI 4: Rritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor penal dhe masave antikorruption përmes konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale.

Fushat e identifikuar të veprimit janë njohur dhe reformat thelbësore në legjislacion, procedurat, proceset dhe sistemet bazohen në strategjinë e sektorit tonë, në masat e duhura të identifikuar dhe në planin zbatues të bazuar në Strategjinë dhe planin tonë të veprimit.



Objektivat Strategjike

Strategjia ka tetë objektiva strategjike të nivelit të lartë:

- OBJEKTIVI 1: Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektivitetit dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë.
- OBJEKTIVI 2: Konsolidimi i arsimit ligjor dhe trajnimit, si dhe specializimi i magjistratëve dhe personelit të gjykatave.
- OBJEKTIVI 3: Përmirësimi i operimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe qasjen e tij në përputhje me standardet evropiane.
- OBJEKTIVI 4: Rritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor penal dhe masave antikorruption përmes konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale.
- OBJEKTIVI 5: Përmirësimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë duke siguruar sisteme moderne elektronike dhe lehtësira për zhvillimin e bashkëpunimit të fuqishëm ndërkombëtar.
- OBJEKTIVI 6: Shtimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin ndëshkimor.
- OBJEKTIVI 7: Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj vartëse.
- OBJEKTIVI 8: Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve ligjore dhe vendosja e një kuadri ligjor për arbitrazhin.

Këto objektiva përputhen me SKZHI 2015-202 që deklaron vizionin e mëposhtëm lidhur me sektorin e drejtësisë: "Shqipëria: një vend i bazuar te shteti ligjor, garantuese e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, me një sistem drejtësie të hapur dhe të barabartë që garanton drejtësi për të gjithë" me objektivat e mëposhtme strategjike:

1. Konsolidimi i pavarësisë dhe efikasitetit të gjyqësorit,
2. Rritja e transparencës dhe konsolidimi i besimit publik te drejtësia ,
3. Përmirësim i mëtejshëm i shërbimeve publike dhe ekzekutimit privat, si dhe performanca e shërbimeve ligjore,
4. Arritja e të drejtave personale bazë dhe shndërrimi i ndëshkimit penal për qëllime ri-edukimi,
5. Përmirësimi i mëtejshëm i infrastrukturës së burgjeve dhe elementëve të sigurisë në burgje, si dhe i sistemeve të paraburgimit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe konventat, instalimi i kamerave në gjithë institucionet ndëshkimore dhe shndërrimi gradualisht i strukturave për të mitur në struktura të hapura ose pjesërisht të hapura.
6. Ngritja e një baze elektronike të dhënash për të burgosurit përmes softuerit të sistemit për të kërkuar dosjet, ndërlidhja online e burgjeve vendore dhe qendrave të paraburgimit dhe institucionit qendror të sistemit të menaxhimit të bazës së të dhënave dhe statistikave informative.



KREU III: POLITIKAT

Në përputhje me vizionin, prioritetet strategjike dhe qëllimet, ky kapitull trajton politikat që do të ndërmerren për të arritur qëllimin. Politikat janë të formuluar në kuptim të objektivave specifike që duhen arritur ose masave që duhen arritur për realizimin e qëllimit. Çdo masë është detajuar më tej në aktivitete. Çdo aktivitet buxhetohet në përputhje me rrethanat, është programuar në kohë dhe i është caktuar një institucion përgjegjës (shih Planin e Veprimit).

Objektivi 1: Forcimi i pavarësisë, efikasitetit dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë

Ky objektivi do të arrihet përmes masave treguese të mëposhtme, në bazë të një analize të mangësive përkundër standardeve të Bashkimit Evropian dhe kërkesave të komunitetit ndërkombëtar. Është e qartë se Ministri dhe qeveria do të duhet të bien dakord me drejtimin e politikave dhe implikimet e burimeve.

- Përmirësimi i statusit të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, duke përfshirë asistent magistratët / këshilltarët ligjorë në bazë të standardeve evropiane për të për të garantuar emërimet dhe zhvillim të karrierës objektive, transparente dhe sipas meritës
- Zbatimi i ndryshimeve të sistemit dhe ndryshimeve organizative për të përmirësuar funksionimin dhe efikasitetin në funksion të ndryshimeve kushtetuese për Gjykatën Kushtetuese
- Krijimi i një inspektorati të veçantë të pavarur të ngarkuar me përgjegjësinë për të hetuar shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe për të zhvilluar shërbime të tjera të inspektimit në gjykata dhe prokurori në pajtim me standardet evropiane.
- Riorganizimi i hartës së gjyqësorit dhe prokurorisë, si edhe të policisë gjyqësore dhe shpërndarja e gjykatave, në përputhje me ndarjen e re territoriale, numrin e popullsisë dhe çështjeve të prapambetura gjyqësore me qëllim që të forcohet roli dhe funksionimi i gjykatave dhe të garantohet qasja në drejtësi:
- Zbatimi i kuadrit të ri ligjor për rritjen, forcimin dhe përmirësimin e organizimit gjyqësor dhe administratës gjyqësore.
- Përmirësimi i funksionimit të KLD dhe zgjerimi i fushës së kompetencave të tij, duke i vënë gjykatat më të larta nën ombrellën e tij dhe duke zgjeruar funksionet në lidhje me TIK, buxhetin gjyqësor, administrimin gjyqësor, raportimin dhe marrëdhëniet me publikun në bazë të standardeve evropiane dhe ndërkombëtare
- Krijimi i KLP dhe ngritja e kapaciteteve për të përmbushur standardet bashkëkohore evropiane dhe zbatuar ndryshimet e fundit legjislative.
- Përmirësimi i efikasitetit të Gjykatës së Lartë dhe zvogëlimi i numrit të çështjeve të prapambetura
- Mbështetje për krijimin dhe operimin e një Këshilli të Emërimeve në Drejtësi në mënyrë që të rishikojë CV-të e anëtarëve të institucioneve të drejtësisë të cilët zgjidhen nga Kuvendi, me qëllim që të ulet ndikimi politik (organi ad hoc/special)
- Përmirësimi i sistemit të arkivit të Gjyqësorit përmes zbatimit dhe funksionimit të arkivave gjyqësore qendrore

**Objektivi 2: Konsolidimi i arsimit dhe formimit ligjor si edhe specializimi i magjistratëve dhe personelit të gjykatave**

Ky objektivi do të arrihet përmes masave treguese të mëposhtme, në bazë të një analize të mangësive përkundër standardeve të Bashkimit Evropian dhe kërkesave të komunitetit ndërkombëtar. Është e qartë se Ministri dhe qeveria do të duhet të bien dakord me drejtimin e politikave dhe implikimet e burimeve.

- Krijimi i një kuadri ligjor për një provim shteti për avokatët si parakusht për ushtrimin e profesionit (për magjistratët, prokurorët, avokatët, noterët, përmbauesit, avokatët e shtetit dhe nëpunësit civilë)
- Thellimi dhe zgjerimi i gamës së aktiviteteve formuese të Shkollës së Magjistraturës, në lidhje me:
 - o Formim bazë të gjyqtarëve dhe prokurorëve kandidatë (specializim më të thelluar, profesionalizëm dhe përmirësim të profesionalizmit dhe etikës) - trajnim i vazhdueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët - trajnim fillestar dhe i vazhdueshëm për kategori të ndryshme të punonjësve të gjykatës - programe të detyrueshme të trajnimit për stafin e institucioneve që kryejnë funksione ndihmëse.
- Transformimi gradual i Shkollës së Magjistraturës në një qendër burimore dhe pikë takimi e legjislacionit të Bashkimit Evropian dhe legjislacionit evropian për të Drejtat e Njeriut.

Objektivi 3: Përmirësimi i funksionimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe qasjen në pajtim me standardet evropiane

Ky objektivi do të arrihet përmes masave treguese të mëposhtme, në bazë të një analize të mangësive përkundër standardeve të Bashkimit Evropian dhe kërkesave të komunitetit ndërkombëtar. Është e qartë se Ministri dhe qeveria do të duhet të bien dakord me drejtimin e politikave dhe implikimet e burimeve.

- Përmirësimi i legjislacionit me qëllim rritjen e efikasitetit të procedurave gjyqësore veçanërisht në drejtim të:
 - o Përmirësimit të sistemit të njoftimeve; - sigurimi i mjeteve për parandalimin e shtyrjes së gjykimeve, - futja e procedurave të përshpejtuara - filtrimi i kritereve, - kërkimi i arsytimit në të njëjtën kohë me vendimin e gjykatës / me shpalljen e vendimit - publikimi elektronik në kohë i vendimeve gjyqësore.
- Krijimi i një sistemi të arsyeshëm dhe proporcional të tarifave gjyqësore për të siguruar financimin e shërbimeve të drejtësisë, si dhe garantimin e qasjes në gjykatë.
- Krijimi i një sistemi të drejtë dhe funksional të ndihmës ligjore për individët dhe grupet në nevojë
- Përmirësimi i marrëdhënieve mes medias dhe gjykatave dhe sigurimi i qasjes publike në informacionin me interes publik.

**Objektivi 4: Rritja e efikasitetit të sistemit të drejtësisë penale dhe masave antikorrupsion përmes konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale**

Ky objektivi do të arrihet përmes masave treguese të mëposhtme, në bazë të një analize të mangësive përkundër standardeve të Bashkimit Evropian dhe kërkesave të komunitetit ndërkombëtar. Është e qartë se Ministri dhe qeveria do të duhet të bien dakord me drejtimin e politikave dhe implikimet e burimeve.

- Rritja e pavarësisë së brendshme dhe të jashtme të prokurorëve dhe prokurorisë duke shqyrtuar kompetencat e hetimit dhe përfaqësimit të prokurorisë në gjykatë dhe duke nxitur kontrollin efektiv dhe ekuilibrin e këtyre kompetencave nga ana e strukturave përgjegjëse
- Krijimi dhe vënia në funksionim e një strukture të Specializuar Antikorrupsioni në nivel kombëtar e përbërë nga policia, prokuroria dhe gjykata.
- Zbatimi i ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale në harmoni me standardet evropiane.
- Përmirësimi i legjislacionit penal në përputhje me standardet evropiane.
- Forcimi i kapaciteteve të PP për të kryer procesin e dekriminalizimit në mënyrë efektive siç parashihet me ligj.
- Mbështetje për strategjinë e përgjithshme antikorrupsion në kuadër të Ministrisë dhe sistemit të drejtësisë për të arritur një nivel performace në përputhje me standardet evropiane

Objektivi 5: Përmirësimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë duke siguruar procedurat dhe lehtësirat moderne të sistemeve elektronike për zhvillimin e bashkëpunimit të fuqishëm ndërkombëtar

Ky objektivi do të arrihet përmes masave treguese të mëposhtme, në bazë të një analize të mangësive përkundër standardeve të Bashkimit Evropian dhe kërkesave të komunitetit ndërkombëtar. Është e qartë se Ministri dhe qeveria do të duhet të bien dakord me drejtimin e politikave dhe implikimet e burimeve.

- Krijimi i një platforme TIK për funksionimin e sistemeve elektronike të gjyqësorit
- Përmirësimi i funksioneve të TIK dhe shërbimeve mbështetëse për sistemet elektronike të gjyqësorit
- (Krijimi i qendrës së centralizuar të mbështetjes së funksionimit të TIK (ITOSC) që do të mbulojnë sistemet TIK të gjykatave, KLD, KLP, HIC, Këshilli i Emërimeve)
- Zbatimi i një sistemi të ri të menaxhimit të çështjeve të gjykatave (ICMIS)
- Përmirësimi i funksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve të shërbimit të prokurorit (CAMS) dhe përshtatja e tij me ndryshimet organizative të institucionit
- Përmirësimi i informacionit statistikor siguruar nga sistemet e menaxhimit të çështjeve gjyqësore si një zgjidhje e përkohshme deri në funksionimin e ICMIS
- Krijimi i një sistemi elektronik publikimi pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare
- Krijimi i një sistemi të ri përmbarimi për të përmbushur standardet bashkëkohore evropiane.
- Përmirësimi i funksionimit të sistemit të vuajtjes së dënimit duke siguruar sistemet e nevojshme të teknologjisë deri në vitin 2020.



- Përmirësimi i kushteve të punës në PP dhe prokuroritë e qarqeve sipas standardeve bashkëkohore
- Përmirësimi i kushteve të punës në gjykata sipas standardeve bashkëkohore

Rritja e efektivitetit të hetimit për të përmbushur standardet ndërkombëtare, duke rritur efikasitetin dhe decentralizimin e përgjimit

Objektivi 6: Përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin ndëshkimor

Ky objektivi do të arrihet përmes masave treguese të mëposhtme, në bazë të një analize të mangësive përkundër standardeve të Bashkimit Evropian dhe kërkesave të komunitetit ndërkombëtar. Është e qartë se Ministri dhe qeveria do të duhet të bien dakord me drejtimin e politikave dhe implikimet e burimeve.

- Shtimi i mundësive për punësim të të burgosurve dhe ofrimi i programeve të riaftësimi dhe ri-integrimit në bazë të praktikave më të mira evropiane
- Ulja e mbipopullimit në burgje dhe paraburgim në përputhje me standardet evropiane
- Garantimi i mbrojtjes së të drejtave themelore të të burgosurve me probleme të shëndetit mendor.
- Përmirësimi i nivelit të burimeve njerëzore të caktuara për riaftësimin e të burgosurve
- Forcimi dhe përmirësimi i shërbimit të provës me standarde moderne evropiane.
- Përmirësimi i sigurisë fizike të burgjeve, si dhe parandalimi dhe mbikëqyrja e komunikimit nga ana e të burgosurve. Përcaktimi i një niveli të pranueshëm të kualifikimit për drejtorët e burgjeve
- Krijimi i MIS të centralizuar për GDP

Objektivi 7: Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj vartëse

Ky objektivi do të arrihet përmes masave treguese të mëposhtme, në bazë të një analize të mangësive përkundër standardeve të Bashkimit Evropian dhe kërkesave të komunitetit ndërkombëtar. Është e qartë se Ministri dhe qeveria do të duhet të bien dakord me drejtimin e politikave dhe implikimet e burimeve.

- Rritja e kapacitetit të Departamentit të Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë, duke përdorur gjyqtarët dhe prokurorët e komanduar në departamentin e kodifikimit dhe duke kontribuar me këshilla për projektet e ndryshme ligjore
- Rritja e kapacitetit të Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar në MD, duke shtuar ekspertizë të jashtme
- Forcimi i kapaciteteve të MD për të përgatitur rregullimin e legjislacionit vendas sipas *acquis communautaire*
- Shtimi i ekspertizës së specializuar të Institutit të Mjekësisë Ligjore
- Rritja e kapaciteteve institucionale dhe profesionale të Komitetit Shqiptar të Birësimi
- Hartimi dhe krijimi i sistemeve të menaxhimit, aktiviteteve operacionale dhe të kontrollit dhe funksionimit financiar të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera (KLD, KLP,



Inspektorati i ri, Këshilli i Emërimeve) për t'u mundësuar të administrojnë procesin e reformës.

- Lidhur me objektivin 6, do të sigurohet mbështetje për të gjitha institucionet e reja dhe të ndryshuara, për të siguruar zbatimin e sistemeve të reja të menaxhimit, aktivitetet operacionale dhe kontrolluese dhe funksionimin financiar të Ministrisë së Drejtësisë (KLD, KLP, Inspektorati i ri, Këshilli i Emërimeve) për t'u mundësuar të administrojnë procesin e reformës.
- Krijimi i një sistemi për kryerjen e vlerësimit të ndikimit rregullator të legjislacionit dhe lidhjen me politikat sektoriale
- Krijimi i një sistemi për kontrollin e korrupsionit në aktet ligjore dhe projekt-aktet ligjore.
- Përmirësimi i sistemit të njoftimit publik dhe konsultimit të legjislacionit.
- Forcimi i Departamentit të Inspektimit të institucioneve të varësisë dhe profesioneve të lira

Objektivi 8: Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve juridike dhe krijimi i një kuadri ligjor për arbitrazh

Ky objektivi do të arrihet përmes masave treguese të mëposhtme, në bazë të një analize të mangësive përkundër standardeve të Bashkimit Evropian dhe kërkesave të komunitetit ndërkombëtar. Është e qartë se Ministri dhe qeveria do të duhet të bien dakord me drejtimin e politikave dhe implikimet e burimeve.

- Përmirësimi i komunikimit me anë të TIK mes avokatëve dhe gjykatave.
- Zbatimi i kuadrit legjislativ për noterët, duke garantuar një autonomi më të madhe të Dhomës së Noterëve dhe duke përfshirë p.sh. organizimin e Dhomës së Noterëve, përgatitjen e noterëve kandidatë për profesionin, rritjen e autonomisë së dhomës, rritjen e profesionalizimit të noterëve, p.sh. nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm dhe riorganizimit të provimit të licencimit të për noterëve.
- Forcimi i ndjekjes disiplinore të noterëve, në veçanti forcimi i organeve disiplinore dhe zbatimi i rregullave të qarta dhe pa kompromis kundër korrupsionit, duke përfshirë masa të rrepta procedurale (pezullimin dhe heqjen e licencës). Forcimi i dispozitave për sigurimin profesional të noterëve.
- Përgatitja e noterëve kandidatë për profesionin duke përmirësuar trajnimin e detyrueshëm fillestar dhe të vazhdueshëm për noterët, duke përfshirë p.sh. e-justice (drejtësia online)
- Zgjerimi dhe forcimi i shërbimeve të ofruara nga noterët nëpërmjet digjitalizimit të plotë të veprimtarisë së tyre.
- Forcimi i kapaciteteve të shërbimit përbarimor në optikën profesionale, operacionale dhe financiare.
- Përmirësimi i kapacitetet e sistemit të përbarimit privat
- Forcimi i rolit të ndërmjetësve dhe përmirësimi i kuadrit ligjor për zbatimin e ndërmjetësimit në procedurat civile, tregtare, familjare penale dhe administrative



KREU IV: NDIKIMI FINANCIAR

Kostoja e përgjithshme për zbatimin e Planit të Veprimit për vitin 2017-2021 për Reformën e Sektorit të Drejtësisë është vlerësuar në 98,385,653 Euro, të cilat shpërndahen si më poshtë mbi llojet e shpenzimeve dhe viteve:

Kategoria	2017	2018	2019	2020	2021	Totali	% e totalit të përgjithshëm
Kapitale	6.666.978	14.425.000	9.836.000	5.240.000	3.619.922	39.787.900	40,44%
Pagat	5.286,060	5.346.060	12.066.260	12.106.260	12.106.260	46.910.900	47,68%
Trajtime	885.000	260.000	310.000	222.000	195.000	1.872.000	1,90%
Shpenz. tjera aktuale	1.919.713	707.285	2.172.285	2.590.285	2.425.285	9.814.853	9,98%
Totali i Përgjithshëm	14,757,751	20,738,345	24,384,545	20,158,545	18,346,467	98,385,653	100,00%

Për të trajtuar qëndrueshmërinë financiare, Plani i Veprimit, i cili është i lidhur me Strategjinë e Sektorit të Drejtësisë, është kostuar dhe pjesërisht është buxhetuar. Ekzistojnë disa çështje financiare të qëndrueshmërisë që rezultojnë nga ndryshimet në legjislacion, si dhe në strukturën institucionale të sistemit të drejtësisë, duke çuar në krijimin e institucioneve të reja; riorganizimi i të tjerave dhe rritjen e statusit të aktorëve të sistemit të drejtësisë, kryesisht gjyqtarë dhe prokurorë, duke rritur pagat e tyre dhe përfitime dhe garanci të tjera. Punësim të personelit të ri, rritje e pagave aktuale dhe shpenzimet e mirëmbajtjes për sistemet e reja të TI-së krijojnë një barrë të vazhdueshme në buxhetin e shtetit.

Në mënyrë që të vlerësojmë më mirë qëndrueshmërinë financiare të reformës, në tabelën e mëposhtme analizohen burimet e financimit dhe hendeku financiar gjatë periudhës së zbatimit 2017-2021 nga qëllimet dhe objektivat:



Qëllimi/Objekti	Kostoja Totale në EURO	FINANCIMI				Hendeku financiar
		Buxheti i shtetit	Financimi i pjesshëm	Donatorët	Dhomat, institucionet e tjera publike	
Totali i Përgjithshëm	98,385,653	3,302,000	1,334,000	1,015,000	449,000	92,285,653
QËLLIMI 1 - FORCIMI I PAVARËSISË, EFIÇENCËS, EFIKASITETIT DHE PËRGJEGJËSISË SË INSTITUCIONEVE TË SISTEMIT TË DREJTËSISË	42,701,581	80,000	639,000	275,000	0	41,707,581
Objekti 1.01 Rritja e statusit të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, duke përfshirë ndihmës magistratë / këshilltarë ligjorë sipas standardeve evropiane, duke siguruar emërim të bazuar në meritë, emërim dhe transparencë dhe zhvillim të karrierës. (Përfshih gjykatën kushtetuese). Krijimi i një qasjeje të zhvillimit të karrierës për të gjithë profesionistët brenda sistemit gjyqësor	27,426,684	80,000	0	20,000	0	27,326,684
Objekti 1.02 Zbatimi i ndryshimeve të sistemit dhe ndryshimeve organizative, me qëllim përmirësimin e funksionimit dhe efikasitetit në funksion të ndryshimeve kushtetuese	452,171	0	75,000	0	0	377,171
Objekti 1.03 Themelimi i një inspektoriati unik të pavarur i ngarkuar me përgjegjësinë për të hetuar sjelljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe për të zhvilluar shërbime të tjera të inspektimit në gjykata dhe prokurori në përputhje me standardet evropiane.	7,352,857	0	120,000	185,000	0	7,047,857
Objekti 1.04 Riorganizimi i hartës gjyqësore dhe prokuroriale, si dhe i policisë gjyqësore dhe shpërndarja e gjykatave në pajtim me ndarjen e re territoriale, numrin e popullsisë dhe numrin e lëndëve të pazgjidhura të gjykatave me qëllim forcimin e rolit dhe funksionimit të gjykatave Dhe për të siguruar qasje në drejtësi	274,000	0	24,000	0	0	250,000
Objekti 1.05 Themelimi i një kuadri ligjor për rritjen, forcimin dhe përmirësimin e organizimit të gjykatave dhe administratës gjyqësore për të përmbushur standardet evropiane të praktikës së mirë	230,000	0	210,000	20,000	0	0
	3,595,872	0	50,000	40,000	0	3,505,872



Qëllimi/Objektivi	Kostoja Totale në EURO	FINANCIMI				Hendeku financiar
		Buxheti i shtetit	Financimi i pjesshëm	Donatorët	Dhomat, institucionet e tjera publike	
Objektivi 1.06 Rrija e funksionimit të KLGJ-së dhe zgjerimi i fushëveprimit të kompetencave të tij, duke sjellë gjykatat më të larta në kuadër të fushëveprimit dhe zgjerimit të funksioneve, p.sh. në lidhje me TI, buxhetin gjyqësor, administratën gjyqësore, raportimin dhe marrëdhëniet me publikun bazuar në standardet evropiane dhe ndërkombëtare	3,049,997	0	40,000	10,000	0	2,999,997
Objektivi 1.07 Themelimi i HPC dhe ngritja e kapaciteteve për të përbushur standardet moderne evropiane dhe për të zbatuar ndryshimet e fundit legjislative	10,000	0	10,000	0	0	0
Objektivi 1.08 Rrija e efikasitetit të gjykatës së lartë dhe zvogëlimi i numrit të lëndëve të mbetura në përputhje me standardet e njohura evropiane për efikasitetin e gjykatave	110,000	0	110,000	0	0	0
Objektivi 1.09 Themelimi i Këshillit të Emërimit të Drejtësisë për të rishikuar CV-të e anëtarëve të institucioneve të drejtësisë, të cilat zgjidhen nga Kuvendi me qëllim të reduktimit të ndikimit politik (organi i posaçëm)	200,000	0	0	0	0	200,000
Objektivi 1.10 Përmirësimi i sistemit arkivor të gjyqësorit përmes zbatimit dhe funksionimit të arkivave të gjykatave qendrore	5,825,000	0	30,000	0	0	5,795,000
QËLLIMI 2 - KONSOLIDIMI I ARSIMIT DHE TRAJNIMIT LIGJOR DHE SPECIALIZIMIN E MAGJISTRATËVE DHE PERSONELIT TË GJYKATËS	40,000	0	30,000	0	0	10,000
Objektivi 2.1 Zbatimi i kuadrit ligjor për një provim shtetëror për avokatët si parakusht për profesionet ligjore (magjistratë, prokurorë, avokatë, noterë, përmbarues, avokatë shtetërorë dhe nëpunës civilë	305,000	0	0	0	0	305,000
Objektivi 2.2 Thelimi dhe zgjerimi i fushës së aktiviteve trajnuese të Shkollës së Magjistraturës, në lidhje me - trajnimin fillestar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të kandidatëve (specializim më i thelluar, profesionalizëm, profesionalizëm dhe etikë) - trajnime të vazhdueshme për gjykatësit dhe prokurorët,						



Qëllimi/Objektivi	Kostoja Totale në EURO	FINANCIMI				
		Buxheti i shtetit	Financimi i pjesëshëm	Donatorët	Dhomat, institucionet e tjera publike	
përfshirë të drejtën e BE-së - Trajnimi fillestar dhe i vazhdueshëm për kategoritë e ndryshme të punonjësvë të gjykatave. - programe trajnimi të detyrueshme për stafin e institucioneve që kryejnë funksione ndihmëse	5,480,000	0	0	0	0	5,480,000
Objektivi 2.3 Transformimi gradual i Shkollës së Magjistraturës në një qendër burimore dhe pikë takimi për të Drejtën e Bashkimit Evropian dhe të Drejtën Evropiane për të Drejtat e Njeriut	4,637,000	0	12,000	10,000	10,000	4,605,000
QËLLIMI 3 - GARANTIMI I EFIKASITETIT, TRANSPARENCA DHE QASJA E SISTEMIT GJYQËSOR DHE E DREJTA PËR ZBATIMIN E PROCESIT JURIDIK NË PËRPUTHJE ME STANDARDET EVROPIANE						
Objektivi 3.1 Përmirësimi i legjislacionit në mënyrë që të përmirësohet efikasiteti i procedurave gjyqësore, sidomos nga: Përmirësimi i sistemit të njoftimeve; - sigurimi i mjeteve që parandalojnë shtyrjen e gjyqimit - futjen e procedurave të përshpejtuara - kriteret e filtrimit - arsyetimin e arsyetimit njëkohësisht me vendimin e gjykatës / me shpalljen e vendimit	17,000	0	2,000	5,000	0	10,000
Objektivi 3.2 Vendosja e një sistemi të arsyeshëm dhe proporcional të taksave gjyqësore, me qëllim të sigurimit të financimit të shërbimeve të drejtësisë, si dhe garantimin e qasjes në gjykatë.	10,000	0	0	0	10,000	0
Objektivi 3.3 Krijimi i një sistemi të ndihmës juridike falas dhe funksionale për individët dhe grupet në nevojë	4,575,000	0	10,000	5,000	0	4,560,000
Objektivi 3.4 Përmirësimi i marrëdhënieve me mediat gjyqësore dhe sigurimi i qasjes së publikut në informata për rastet e interesave publike.	35,000	0	0	0	0	35,000
QËLLIMI 4 - RRIJTJA E EFIKASITETIT TË SISTEMIT TË DREJTËSISË PENALE DHE MASAVE KUNDËR KORRUPSIONIT PËRMES KONSOLIDIMIT TË MISIONIT, STATUSIT DHE FUNKSIONEVE TË INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË PENALE	9,524,670	0	50,000	135,000	0	9,339,670



Qëllimi/Objektivi	Kostoja Totale në EURO	FINANCIMI				Hendeku financiar
		Buxheti i shtetit	Financimi i pjeshëm	Donatorët	Dhomat, institucionet e tjera publike	
Objektivi 4.1 Rritja e pavarësisë së brendshme dhe të jashtme të prokurorëve dhe prokurorisë (në standardet evropiane), duke shqyrtuar kompetencat e hetimit dhe përfaqësimit të prokurorisë në gjykatë dhe duke nxitur kontrollin dhe balancimin efektiv të këtyre kompetencave nga strukturat përgjegjëse	40,000	0	20,000	0	0	20,000
Objektivi 4.2 Themelimi i një strukture të specializuar kundër korrupsionit në nivel kombëtar, i përbërë nga policia, prokuroria dhe gjykatat.	8,956,425	0	0	100,000	0	8,856,425
Objektivi 4.3 Amendimet dhe miratimi i Kodit të Procedurës Penale për ta sjellë atë në përputhje me Standardet Evropiane.	75,000	0	0	10,000	0	65,000
Objektivi 4.4 Përmirësimi i legjislacionit penal në përputhje me standardet evropiane	65,000	0	30,000	0	0	35,000
Objektivi 4.5 Forcimi i kapaciteteve të PP-së për të kryer në mënyrë efektive procesin e dekriminalizimit, siç parashikohet në Ligj	363,245	0	0	0	0	363,245
Objektivi 4.6 Mbështetja e strategjisë së përgjithshme kundër korrupsionit brenda Ministrisë dhe sistemit të drejtësisë për të arritur një nivel të performancës organizative në përputhje me standardet evropiane	25,000	0	0	25,000	0	0
QËLLIMI 5 - PËRMIRËSIMI I FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT TË DREJTËSISË NGA OFRIMI I PROCEDURAVE ME SISTEM ELEKTRONIK MODERN PËR ZHVILLIMIN E BASHKËPUNIMIT TË FORTË NDËRKOMBËTAR .	21,378,302	2,860,000	8,689,922	20,000	0	9,808,380
Objektivi 5.01 Ndertimi i një platforme IT për funksionimin e sistemeve elektronike të gjyqësorit	2,600,000	0	0	0	0	2,600,000
Objektivi 5.02. Përmirësimi i operacioneve të TI-së dhe shërbime mbështetëse për sistemet elektronike në gjyqësor (Vendosja e një operacioni të centralizuar IT dhe qendra	528,380	0	0	0	0	528,380



Qëllimi/Objektivi	Kostoja Totale në EURO	FINANCIMI				Hendeku financiar
		Buxheti i shtetit	Financimi i pjesshëm	Donatorët	Dhomat, institucionet e tjera publike	
mbështetëse (ITOSC) që mbulon sistemet e IT të gjykatave, HJC, HPC, HIC dhe Këshilli i Emërimit)						
Objektivi 5.03 Zbatimi i sistemit të gjykatave / sistemit të menaxhimit të çështjeve të gjykatave (ICMIS) plotësisht funksional	3,090,000	0	0	0	0	3,090,000
Objektivi 5.04 Rritja e funksionalitetit të sistemit të menaxhimit të lëndëve të Shërbimit të Prokurorit (CAMS) dhe përshtatjen e tij me ndryshimet organizative të institucionit	750,000	0	0	0	0	750,000
Objektivi 5.05 Rritja e efikasitetit të proceseve të rasteve të ndihmës së ndërsjellë juridike (MLA)	640,000	0	0	0	0	640,000
Objektivi 5.07 Përmirësimi i informacionit statistikor të ofruar nga sistemet e menaxhimit të çështjeve gjyqësore (Vendosja e një shërbimi statistikor të integruar si një zgjidhje e përkohshme derisa ICMIS të jetë operacionale.)	210,000	0	0	0	0	210,000
Objektivi 5.08 Ngritja e sistemit të publikimit elektronik të Qendrës së Publikimeve Zyrtare	560,000	360,000	200,000	0	0	0
Objektivi 5.09 Ngritja e një sistemi të ri për sistemin përbarimor për të përmbushur standardet moderne evropiane.	60,000	0	0	0	0	60,000
Objektivi 5.11 Përmirësimi i funksionimit të sistemit penitenciar, duke siguruar sistemet e nevojshme të teknologjisë deri në vitin 2020.	2,500,000	2,500,000	0	0	0	0
Objektivi 5.12 Përmirësimi i kushteve të punës ndaj standardeve moderne në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në zyrat e prokurorive të rrethit	30,000	0	30,000	0	0	0
Objektivi 5.13 Përmirësimi i kushteve të punës ndaj standardeve moderne (nga Ndërtimi i ndërtesave të reja për gjykatat e mëposhtme	8,459,922	0	50,000	0	0	8,409,922
Objektivi 5.14 Rritja e efektivitetit të hetimeve për të përmbushur standardet ndërkombëtare, duke rritur efikasitetin dhe decentralizimin e përgjimeve	1,950,000	0	0	20,000	0	1,930,000



Qëllimi/Objektivi	Kostoja Totale në EURO	FINANCIMI				Hendeku financiar
		Buxheti i shtetit	Financimi i pjesshëm	Donatorët	Dhomat, institucionet e tjera publike	
Qëllimi 6. ZHVILLIMI I MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË NJERIUT në sistemin penitenciar	11,148,000	362,000	55,000	10,000	290,000	10,431,000
Objektivi 6.1 Krijta e mundësisë për punësimin e të burgosurve dhe ofrimi i programeve të edukimit / programeve të aftësive jetësore sipas standardeve evropiane	290,000	0	0	0	290,000	0
Objektivi 6.2 Ujia e mbipopullimit dhe përmirësimi i kushteve në burgje dhe parburgim sipas standardeve evropiane	1,350,000	0	0	0	0	1,350,000
Objektivi 6.3 Garantimi i mbrojtjes së të drejtave themelore të të parburgosurve me probleme të shëndetit mendor.	8,026,000	0	0	10,000	0	8,016,000
Objektivi 6.4 Përmirësimi i nivelit të burimeve njerëzore të ndara për rehabilitimin e të burgosurve	17,000	12,000	5,000	0	0	0
Objektivi 6.5 Forcimi dhe përmirësimi i shërbimit të provës me standarde moderne evropiane	1,095,000	50,000	0	0	0	1,045,000
Objektivi 6.6 Përmirësimi i sigurisë fizike të burgjeve, si dhe parandalimi dhe mbikëqyrja e komunikimit nga të parburgosurit. Përveç kësaj, vendosja e një niveli të pranueshëm të kualifikimit për drejtorët e burgjeve	350,000	300,000	50,000	0	0	0
Objektivi 6.7 Vendosja e MIS-it të centralizuar për GDP-në	20,000	0	0	0	0	20,000
QËLLIMI 7 - PËRMIRËSIMI I FUNKSIONIMIT TË MINISTRISË SË DREJTËSISË DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, INSTITUCIONEVE TË REJA OSE TË NDRYSHUARA	2,730,100	0	58,000	565,000	0	2,107,100
Objektivi 7.01 Rrija e kapacitetit të departamentit të kodifikimit në MD, duke përdorur gjyqtarët dhe prokurorët e dërguar në departamentin e kodifikimit dhe duke shtuar këshilla të jashtme për draftet e ndryshme ligjore	827,100	0	20,000	0	0	807,100
Objektivi 7.02 Forcimi i kapacitetit të MD-së, në mënyrë që të përgatitet për përshtatjen e legjislacionit kombëtar me acquis communautaire	88,000	0	28,000	0	0	60,000
	50,000	0	0	0	0	50,000



Qëllimi/Objektivi	Kostoja Totale në EURO	FINANCIMI				Hendeku financiar
		Buxheti i shtetit	Financimi i pjesëshëm	Donatorët	Dhomat, institucionet e tjera publike	
Objektivi 7.03 Rritja e ekspertizës së specializuar të Institutit të Mjekësisë Ligjore	25,000	0	0	0	0	25,000
Objektivi 7.04 Rritja e kapaciteteve institucionale dhe profesionale të Komitetit Shqiptar të Birësimit	110,000	0	0	110,000	0	0
Objektivi 7.05 Hartimi dhe krijimi i sistemeve të menaxhimit, aktiviteteve operative dhe kontrolluese dhe funksionimit financiar të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera për t'u mundësuar atyre që të menaxhojnë procesin e reformës	160,000	0	0	160,000	0	0
Objektivi 7.06 Mbështetje do t'u ofrohet të gjitha institucioneve të reja dhe të ndryshuara për të siguruar zbatimin e sistemeve të reja të menaxhimit, aktiviteteve operative dhe kontrolluese dhe funksionimit financiar të Ministrisë së Drejtësisë për të mundësuar menaxhimin e procesit të reformës (lidhur me objektivin 5)	260,000	0	0	260,000	0	0
Objektivi 7.07 Ngritja e një sistemi për kryerjen e ndikimit rregullator të legjislacionit dhe lidhjeve me politikat sektoriale	260,000	0	0	35,000	0	225,000
Objektivi 7.08 Themelimi i një sistemi për shqyrtimin e korrupsionit të akteve ligjore dhe projekt-ligjeve	540,000	0	10,000	0	0	530,000
Objektivi 7.09 Rritja e sistemit të njoftimit publik dhe konsultimi i legjislacionit	410,000	0	0	0	0	410,000
Objektivi 7.11 Forcimi i Departamentit të Inspektimit të Institucioneve të Pavarura dhe të profesioneve të lira	441,000	0	210,000	0	149,000	82,000
QËLLIMI 8 - PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË SHËRBIMIT TË PROFESIONEVE LJGJORE DHE KRUIIMI I KUADRIT LJGJOR PËR ARBITRAZHIN						
Objektivi 8.01 Përmirësimi i komunikimit të bazuar në TI midis avokatëve dhe gjykatave	10,000	0	10,000	0	0	0
Objektivi 8.02 Zbatimi i Kuadrit legjislativ për noterët, duke përfshirë, p.sh. organizimin e dhomës së noterëve, përgatitja e noterëve kandidatë për profesionin. Sigurimi i rritjes së autonomisë së dhomës. Rritja e profesionalizimit të noterëve,	7,000	0	0	0	0	7,000



Qëllimi/Objektivi	Kostoja Totale në EURO	FINANCIMI				Hendeku financiar		
		Buxheti i shtetit	Financimi i pjesshëm	Donatorët	Dhomat, institucionet e tjera publike			
p.sh. përmes përmirësimit të vazhdueshëm dhe riorganizimit të ekzaminimit të licencës noteriale	25,000	0	0	0	10,000	15,000		
Objektivi 8.03 Forcimi i procedimit disiplinor kundër noterëve, në veçanti përmes forcimit të organeve disiplinore dhe futjes së rregullave të qarta dhe kompromis anti-korruption, duke përfshirë masa të rrepta procedurale (pezullimi dhe heqja e licencës). Forcimi i dispozitave për sigurimin profesional të noterëve	0	0	0	0	0	0		
Objektivi 8.04 Përgatitja e kandidatit për profesionin e Noterit duke përmirësuar trajnimin e vazhdueshëm fillestar dhe të detyrueshëm për noterët, përfshirë drejtësinë elektronike	320,000	0	200,000	0	120,000	0		
Objektivi 8.05 Zgjerimi dhe forcimi i shërbimeve të duhura për noterët, nëpërmjet dixhitalizimit të plotë të aktivitetit të tyre.	60,000	0	0	0	0	60,000		
Objektivi 8.06 Forcimi i kapacitetit të shërbimit përbarimor publik nga perspektiva profesionale, operationale dhe financiare	10,000	0	0	0	10,000	0		
Objektivi 8.07 Përmirësi i funksionimit të sistemit të përbarimit privat etj	9,000	0	0	0	9,000	0		
Objektivi 8.08 Forcimi i rolit të ndërmjetësve dhe përmirësi i kuadrit ligjor për zbatimin e ndërmjetësimit në procedurat civile, tregtare, familjare dhe penale, si dhe administrative								
Totali i Hendekut financiar prej 92,285,653 Euro është shpërndarë si vijon gjatë viteve sipas kategorive të shpenzimeve dhe vitit të zbatimit të Strategjisë:								
Kategoria	2017	2018	2019	2020	2021	Total Euro	Totali në (mijë Lekë)	% e Totalit të përgjithshëm
Kapitale	5,256,978	12,675,000	9,836,000	5,120,000	3,539,922	36,427,900	4,881,339	39.47
Paga	5,286,060	5,346,060	12,066,260	12,106,260	12,106,260	46,910,900	6,286,061	50.83
Trajnime	290,000	65,000	115,000	35,000	35,000	540,000	72,360	0.59
Shpenz. te tjera	1,025,713	610,285	2,085,285	2,320,285	2,365,285	8,406,853	1,126,518	9.11
Totali i përgjithshëm	11,858,751	18,696,345	24,102,545	19,581,545	18,046,467	92,285,653	12,366,278	100.00



Ndërsa është kryer një analizë afatmesme e ndikimit financiar të Strategjisë së Sektorit të Drejtësisë për sa i perket shpenzimeve (sidomos kostot e pagave që rezultojnë nga krijimi i institucioneve të reja), kursimet që do të gjenerohen si rezultat i masave të reformës ende nuk janë vlerësuar në detaje. Kursimet e mundshme mund të rezultojnë nga lufta kundër korrupsionit dhe fitimet e efikasitetit që rezultojnë nga automatizimi. Këto kursime, megjithatë, do të hyjnë në fuqi vetëm pas investimeve dhe si rrjedhojë mund të llogariten vetëm në një masë shumë të kufizuar për periudhën e zbatimit të Strategjisë.

